Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0573

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i Operatorit Ekonomik (GOE)"Alfa.i"&"K-Ing"SH.P.K.,lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i rrjetit te ujësjellësit ne Komunen e Fushe Kosoves ne lagjen 28.29, Bardh i Madhe dhe Sllatine e Madhe " me nr. të prokurimit: "212-23-2115-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) -Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal MAPLme datën 14.11.2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohen, si të pa bazuara ankesat e operatoreve ekonomik: "Alfa.I" e datës 11. 08. 2023 me Nr. 573/23 si dhe ankesa e OE "K-Ing" SH. P.K e datës 14. 08. 2023, Nr. 582/23, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i rrjetit te ujësjellësit ne Komunën e Fushe Kosovës ne lagjen 28.29, Bardh i Madh dhe Sllatinë e Madhe" me nr. të prokurimit: "212-23-2115-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal MAPL.

2. Të mbetet ne fuqi vendimi I Autoritetit Kontraktues.

3.Meqenëse ankesa e GOE ankues është refuzuar si e pabazuar, të njëjtit i konfiskohet tarifa që ka paguar me rastin e parashtrimit të ankesës konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e RKS-së.

Arsyetim

- *Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 24.03.2023, Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal (MAPL), në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i rrjetit te ujësjellësit ne Komunën e Fushe Kosovës ne lagjen 28.29, Bardh i Madh dhe Sllatine e Madhe" me nr. të prokurimit: "212-23-2115-5-1-1".

Me datën 25.07.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

Me datën 31.07.2023 OE ”Alfa.I” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 02.08.2023, AK Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal me vendim ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me datën 31.07.2023, kërkesë për rishqyrtim ka parashtruar edhe OE “K-Ing”SH.P.K, të cilën e ka refuzuar AK me datën 02. 08. 2023.

I pakënaqur me vendimin e AK-së me datën 11.08.2023, OE “Alfa.I”, ka parashtruar ankesë në OSHP e evidentuar me numër protokolli 573/23.

Poashtu, i pakënaqur me vendimin e AK-së me datën 14. 08. 2023, me numër protokolli 582/23.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: Pune, vlera e parashikuar e kontratës: 3.000.000.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105 të LPP.

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 26.08.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesat të refuzohen si të pabazuara;

- Të mbetet në fuqi vendimi i AK-së;

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) dhe veprimet e palëve dhe konsideroi ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, dhe kjo seancë u mbajtë me dt. 19.10.2023. Në seancën e mbajtur me palë, të dy OE ankues potencuan se ka konflikt të interesit në mes të ekspertit shqyrtues dhe OE të rekomanduar për kontratë. Paneli shqyrtues në vazhdimin e seancën ndëgjoi të gjitha palët ankuese rreth eleminimit të tyre nga aktiviteti i prokurimit dhe përgjegjshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë, të njëjtit ri

potencuan pretendimet ankimore dhe qëndruan mbrapa tyre. Po ashtu, edhe përfaqësuesi i AK qëndroj mbrapa njoftimit mbi vendimin e tyre.

Paneli shqyrtues pasi që palët ankues deklaruan konfliktin e mundshëm të interesit në mes të ekspertit shqyrtues dhe OE të rekomanduar për kontratë, atëherë me qëllim që të gjitha palët në procedurë të meritojnë trajtimin e barabartë dhe nën frymën e nenit 7 të LPP, atëherë, vendosi që të kërkoj një superekspertizë, edhe pse paneli ju bëri me dije palëve se vendosja meritore për secilën lëndë bëhet vetëm me prova dhe argumente dhe ekspertiza nuk është detyruese për panelin, përveç se një pasqyrim i gjendjes faktike.

Megjithatë, bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër duke hartuar një super ekspertizë. Lidhur me ketë, me 03.11.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e superekspertizës për lëndën 2023/0573 me rekomandimet si në vijim:

- Ankesat të aprovohet si pjesërisht e bazuar;
- Të mbetet në fuqi vendimi i AK-së;

Ndërsa, lidhur lëndën 2023/0582 , më 06.11.2023 ka dorëzuar raportin e super ekspertizës me rekomandimet si në vijim:

Ankesa të refuzohet si e pabazuar;

Të mbetet në fuqi vendimi i AK;

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, dhe kjo seancë u mbajtë me dt. 19.10.2023.

Raportin e super ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues ka njoftuar Panelin Shqyrtues se pajtohet me rekomandimet e ekspertit ndërsa Operatorët Ekonomik Ankues kanë njoftuar se nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

Pretendimet e Ankuesit "Alfa.I" Nr. 573/23

- *Pretendimi i parë (I)*- Pretendimi i parë i OE ankues kërkesa e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë është: Kërkesa 2. - Dy (2) udhëheqës të punimeve, Inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik ose Master i shkencave hidroteknike, me përvoje minimale prej 5 vite pas diplomimit dhe në udhëheqje të punimeve të ngjashme (kërkesa 2 e dosjes së tenderit), OE ankues thekson se "realisht kontratat nuk kane qenë obligative dhe te nevojshme sepse përvoja është dëshmuar me CV dhe referenca" dhe "kontratat nuk kane ndonjë rëndësi apo

vlere nuk qëndron sepse kjo kërkesë është e përcaktuar qarte ne dosjen e tenderit". Në lidhje me këtë kërkesë ne kemi ofruar dëshmi të mjaftueshme për të plotësuar këtë kërkesë. Për të dy udhëheqësit e punishtes z. Veton Jahaj dhe Idriz Shala, si dhe për dy gjeodetët z. Valon Bislimi dhe z. Ferid Ahmeti, ne e kemi dëshmuar përvojën e tyre përmes CV-së dhe Referencave, ndërsa i kemi sqaruar AK-së, se ne nuk mund të dorëzojmë kontrata për Inxhinierët të cilët kanë të nënshkruar kontrata me kompanitë e tjera pasi që tek ne nuk janë punëtorë të rregullt. Në lidhje me këta punëtorë na janë kërkuar sqarime shtesë dhe ne kemi dhënë përgjigjet me kohë, ku ndër të tjera kemi sqaruar se kontratat e inxhinierëve dhe të gjeodetëve me kompani të tjera janë konfidenciale, mirëpo në të njëjtën kohë i kemi thënë AK-së se mund ti drejtohen vetë inxhinierëve për këto dëshmi. Megjithatë pas konsultimeve me inxhinieret përkatës të cilat na kanë lejuar që të prezantohen kontratat e tyre, ne këto kontrata i kemi bashkangjitur me kërkesë për rishqyrtim edhe pse realisht nuk ka qenë obligative dhe e nevojshme sepse përvoja e tyre është dëshmuar me CV dhe referenca.

- *Pretendimi i dytë (II)*- Pretendimi i OE ankues ka të bëjë me kërkesën: Kërkesa 3. - Një (1) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë; inxhinier i diplomuar i gjeodezisë ose Master i shkencave gjeodezisë me përvojë minimale prej tri (3) vite pas diplomimit, gjithashtu te jete i licencuar nga AKK (Agjensioni Kadastral i Kosovës). Sa i përket gjeodetit të prezantuar nga ne, z. Fisnik Loshi, ju sqarojmë se i njëjti ka diplomën e bachelorit në gjeodezi, ndërsa masterin e ka të përfunduar në Suedi dhe diploma e tij në Suedi është në dy gjuhë (suedeze dhe angleze). Në diplomë shkruan mjaft qartë se z. Loshi është master i shkencave, programi menaxhim i tokave (Land Management) e jo Master i teknologjisë siç pretendon AK-ja, prandaj kjo arsye e eliminimit është e paqëndrueshme. Për më tepër inxhinieri në fjalë ka Licencën e gjeodetit dhe atë të vlefshme nga 05.10.2018 shumë vite se sa kërkesa e dosjes së tenderit (prej tri vite). Ky gjedoet është i regjistruar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Ne kemi kërkuar sqarime nga universiteti ku i ka kryer studimet z. Fisnik loshi dhe nga ky universitet është sqaruar se titulli Tekonologie masterexamen në gjuhen angleze përkthehet si Master of Science, e që në shqip përkthehet Master i Shkencave. Ky fakt vërehet edhe ne sylabusin e bashkangjitur nga fakultetit ku shkruan: Students who have successfully completed the programme will be awardcd a "Teknologie masterexamen", translated into English as "Degree of Master of Science (two years)". Duke pasur parasysh këtë sqarim rezulton se ky arsyetim i AK është i pabazë sepse Diploma e z.Loshi është e përkthyer edhe ne gjuhen angleze e në të cilën qartë ceket se është Master i shkencave - drejtimi Menaxhim i tokave. Prandaj, në universitet tjera nuk do të thotë se titulli të merret sikurse në Universitet të Prishtinës-vetëm gjeodet por me rëndësi është të përputhet programi i studimeve.

- *Pretendimi i tretë (II)*- Në lidhje me arsyen e tretë të eliminimit, ju sqarojmë se në nenin 9.1&9.2 të DT-së tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale tek kërkesa 9 janë kërkuar si: Kërkesa 9. Kontrata të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, të përfunduara me Sukses gjatë 3 (tre) vitet e fundit, deri në datën e publikimit të këtij Njoftimi të Kontratës; Vlera Totale e Kontratave të natyrës së punëve të ngjashme si të tilla mund të konsiderohen të gjitha referencat për punimet e infrastrukturës si Ujësjellës, Kanalizime, dhe Rrugë te jete min 4,000,000.00 Euro. OE te ketë se paku 1,000,000.00 euro, mund të mbulohet me disa Referenca për punë të njëjta

(Punime të rrjetave të Ujësjellësit). Në lidhje me këtë kërkesë, ne kemi dorëzuar kontrata të natyrës së ngjashme në vlerë prej 6.3 milion euro, prandaj kemi plotësuar kërkesën e lartcekur në FDT, e po ashtu kemi plotësuar kriterin për kontrata në ujësjellës prej minimum 1 milion Euro. Edhe nëse AK-ia nuk i ka pranuar dy referencat tjera atë të UP dhe KK Prizren: MMPH Ujësjellësi ne Kaçanik- 1,235,638.36 Euro; KK Podujeve Sheshi ne Podujeve (ujësjellës, kanalizim, rruge) - 2,269,821.95 Euro KUR Prishtina Ujësjellësi ne Lipjan, Podujeve - 170,162.65 Euro, CDI Rehabilitimi i pusetave - 108,985.28 Euro, CDI Ujësjellësi ne Malisheve - 253,945.97 Euro, KK Kaçanik Ujësjellësi ne Kaçanik - 46,396.25 Euro; KK Istog Ujësjellësi ne Banje - 117,300.50 Euro; KK Istog Ndërtimi i skemës për furnizim me ujë - Rrjeti Sekondar - 246,704.07. Vlera Totale e vetëm këtyre referencave është: 4,448,955.03 Euro, pra mbi vlerën e 1 së AK.

Konstatimet në super ekspertizë e ekspertit shqyrtues për ankesën 573/23

- *Konstatimi i parë (I)*- OE ankues për kërkesën e 2 ka dorëzuar dështmitë për inxhinieret V.J dhe I.SH. Ne oferte OE ankues nuk ka bashkangjitur "Kontratë/a pune e cila dështmon përvojën 5 vjeçare" për inxhinieret sipas kërkesës se dosjes se tenderit. Pretendimi i OE ankues se "realisht kontratat nuk kane qenë obligative dhe te nevojshme sepse përvoja është dështmuar me CV dhe referenca" dhe "kontratat nuk kane ndonjë rëndësi apo vlere " nuk qëndron sepse kjo kërkesë është e përcaktuar qarte ne dosjen e tenderit. Për me tepër OE ankues ne fazën e tenderimit ka pas mundësinë qe ta atakojë kërkesën e mësipërme por nuk e ka bërë një gjë te tillë. AK-ja ne përputhje nenin 38.1 te RRPP 38.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK "Kërkesë për sqarim të tenderit". Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike kishte kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues në lidhje me dështmitë që kanë të bëjnë dështmitë e kontratave të punës për inxhinieret. OE ankues ka kthyer ka kundërshtuar dhënien e dështmive me përgjigjen: Përvoja qe i referohet OE ankues e Inxhinierit I.SH sipas CV nga viti 2011 - 2021 është me OE ankues (ALFA I) (përveç 2014-2015 qe është me Infratek). "Përgjigjja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen prej nesh me shkrim në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues ose në numrin e faks-it [038 200 64207] apo në e-mailit [shkelzen.hoxha@rks-gov.net brenda dy [2] ditëve nga data e kësaj kërkese. Pa përgjigjën nga ana e juaj në pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të lartë shënuar, tenderi i juaj do të refuzohet." OE ankues ka dështuar që ti dorëzojë dështmitë e kërkuara nga AK-ja sipas kërkesës për sqarim dhe ka vendosur në përputhje me nenin 38 te RRPP 001/2022 paragrafët 38.6 AK do të caktoj afat kohor të arsyeshëm për OE për sqarim të tenderit të tyre. 38.7 Nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK sipas paragrafit 38.6 tenderi përkatës do të refuzohet. Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja ne këtë pike ankimore ka vepruar ne përputhje me Nenin 38.7 te RRPP 001/2022 dhe nenin 7-Barazia në trajtim/ jo- diskriminimiuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Autoriteti kontraktuesdo titrajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhejo- diskriminuese dhe do Të veprojë nëmënyrë transparente. Prandaj pretendimi ankimor për këtë pike nuk është i bazuar.

- *Konstatimi i dytë (II)*- Eksperti shqyrtues sqaron se me ofertë OE ankues ka dorëzuar dëshmi për F.L i cili diplomën Master e ka dorëzuar nga Suedia me titullin "Teknologie masterexamen" dhe me gradën e fituar "Master i shkencave". OE ankues i referohet programit te studimeve si "Menaxhim i tokave". Ne nostrifikimin e diplomës nga Ministria e Arsimit me nr. 6/4-1641 poashtu vërtetohet se grada e fituar është "Master i Shkencës" duke mos ju referuar programit te studimit. Sidoqoftë F.L ishte licencuar nga MMPH sipas licencës me numër 76 te datës 05.10.2023 ku i njëjti licencohet si Gjeodet prandaj bazuar ne dëshmitë dhe provat e prezantuara eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor ne këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

- *Konstatimi i tretë (III)*- Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues me ofertën e tij ka dorëzuar listën e kontratave për te cilat ka bashkangjitur referenca apo pranime teknike. Gjate fazës se kërkesës për rishqyrtim OE ankues ka pretenduar se ne listën e kontratave te dorëzuara janë kontratat te cilat pretendon se i plotësojnë kriteret sipas dosjes se tenderit sipas listës me poshtë: AK-ja me vendimin ne kërkesë për rishqyrtim ka vlerësuar se kontratat nuk e përmbushin kriterin sipas dosjes se tenderit ne vlere prej 4,000.000.00. Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues nw ofertw ka prezantuar listën me kontrata dhe vlerësojmë se OE e arrinë dhe tejklalon kërkesën e AK-se per pune te ngjashme. Bazuar ne këto qe u ceken me lart vlerësojmë se pretendimi ankimore eshte i bazuar.

Pretendimet ankimore të OE "K-ING sh.p.k, "Urban O.P" & "Hidro Project" SH.P.K, Nr. 582/23

- *Pretendimi i parë (I)*- Si shkelje procedural në lidhje gjatë fazës së këtij aktiviteti të Prokurimit, procesi hapjeve të tenderit, Afati i fundit për dorëzim të ofertave sipas dosjes të tenderit (DT) ka qenë me datë 05.06.2023, ora 14:00:00 dhe hapja ofertave me datë 05.06.2023 ora 14:00. Ndërsa hapja ofertave është dërgua me datë 06.06.2023, pas kërkesës tonë me email, ne nuk jemi njoftu për problemet që ka dhënë AK në vendimin kërkesën për rishqyrtim edhe pse dokumentacioni i bashkangjitur nuk shihen detalet e emailit drejtuar KRPP. Kërkesa në dosje të tenderit në lidhje me afatin e fundit të dorëzimit të tenderëve dhe hapja e tenderëve.

- *Pretendimi i dytë (II)*- U sqarua se afati i fundit për dorëzim të ofertave sipas kërkesës së DT, me datë 05.06.2023, ndërsa ne kemi marrë Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me datë 25.07.2023, një shkelje procedural pa na njoftuar për nevojat rreth zgjatjes së afatit në lidhje me vendimin e AK.

- *Pretendimi i tretë (III)*- Deklarata mbi fakte dhe argumente: Me datën 27.07.2023, ora 15:31, në platformën E-prokurimit, kemi pranuar formularin B58, Njoftim për vendimin e AK, me të cilin nuk pajtohemi fillimisht me arsyet e eliminimit tonë dhe poshtu me rekomandimin e një operatori ekonomik i cili është i papërgjegjshëm. Në vijim i paraqesim faktet dhe argumentet tona lidhur me arsyet e eliminimit. Në letrën standarde të tenderuesit të eliminuar si arsye të eliminimit AK ka përmendur një reference e cila sipas AK nuk është lëshuar brenda periudhës së kërkuar në dosje të tenderit dhe rrjedhimisht sipas AK, nuk e plotësojmë kërkesën për 60% te vlerës se kontratave si lider. Bazuar në dispozitat ligjore që përcaktohen në nenin 59 të LPP-së, vlerësimin e ofertave duhet ta bëni në përputhje me nenin si autoritet kontraktues, vlerësimin e

ofertave duhet ta bëni në përputhje me paragrafin 4 të nenit 59 te LPP-së, sepse në këtë paragraf thuhet: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Vlerësimi i AK-së se nuk e plotësojmë kërkesën është në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 56 të LPP-së, sepse na keni eliminuar për një kërkese e cila nuk ekziston në dosje të tenderit. Nga arsyetimi i kontrate, por kjo kërkesë nuk ekziston në dosje të tenderit as ne njoftimet për korrigjim/përmirësim të gabimeve të publikuara në platformën e E-Prokurimit. Kërkesa e AK ka qenë shumë e qartë, sepse është kërkuar kontrata dhe referenca në tri vitet e fundit deri ne publikimin e njoftimit te kontratës, që do të thotë deri me datën: 24.03.2023 dhe pranimi teknik sipas pretendimeve të AK se nuk përmbush kërkesën është e lëshuar me muajin shkurt, është dashur të merret parasysh sepse është brenda kërkesës së përcaktuar në dosje të tenderit dhe po e përsërisim se kjo arsye e dhënë nga ana juaj është ne kundërshtim me nenin 56.3 te LPP-së

- *Pretendimi i katërt (IV)*- Sa i përket arsye së eliminimit qe ka te bëjë me 1 (një) makinë për shpuarjen nëntokësore horizontale me sistem laserik të kontrollit deri në diametrin 500 mm., ku ju deklaroni se keni ofruar makinën për shpim horizontal me pjese përcjellëse marka dith itch jet track tip: 2720, e cila nuk është ne përputhje me kërkesën e AK-së. Kjo arsye nuk qëndron se me një kërkim të thjeshte në internet mund ta verifikoni se pajisja në fjale është në përputhje të plot me kërkesën e dosjes së tenderit. Konsiderojmë në këtë rast keni shkelur nenin 59 dhe 72 të LPP-së, sepse është dashur ta verifikojnë si AK, paraprakisht para se të vendoset se a i plotëson specifikat teknike paisja në fjalë apo jo. Nëse nuk e ka pasur të qartë dokumentacionin e prezantuar, ju kishim ofru informata shtesë, tek kjo makineri me rëndësi të veçante janë aksesorët se me çfarë diametri do të realizohet shpimi, i bie që diametri i shpimit caktohet në bazë të aksesoreve shtesë. Meqë në dosje të tenderit ka qenë tek kërkesa 5, teknike profesionale, AK të verifikoj në teren paisjet e ofruara, ne ju ftojmë që për makinerinë e njëjtë ta realizojmë një shpim me diameter 500 mm, dhe ta heqni këtë dilemë që nuk e kanë vërtetuar drejtë.

- *Pretendimi i pestë (V)*- Në vazhdim po i japim faktet dhe argumentet në lidhje me OE i rekomanduar për kontratë, i cili nuk plotëson kërkesat dosjes së tenderit ku AK ka kërkuar: 9.1 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale: Kërkesa nr 2: Një Udhëheqës i Punimeve; Evidenca 2. -Një kopje të noterizuar të diplomës (jo më e vjetër se 1 muaj), dhe një deklaratë të përgatitur dhe nënshkruar nga inxhinieri-udhëheqësi i punimeve, përmes së cilës inxhinieri deklarohet se do jetë i angazhuar në këtë projekt-kontratë; Një kopje të CV-së e nënshkruara nga vet ing.; -Një kopje të kontratës ose para kontratës valide të punës; dhe Minimum një referencë si mbikëqyrës i projekteve te ngjashme; Kontratë/a pune e cila dëshmon përvojën 5 vjeçare. Kemi sqaruar këtë pretendim tek AK, në kërkesën për ri-shqyrtim, OE i rekomanduar ka propozuar për këtë kërkesë inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë – drejtimi hidroteknik, Z. Mirlind Kabashi, në bazë të qasjes së dokumentacionit dhe shoshitjes së tyre kemi vërejt se referencat janë të përgatitura sa për të përmbush njërën prej kërkesave, e cila ka qenë: Minimum një referencë si mbikëqyrës i projekteve të ngjashme OE i rekomanduar për Z. Mirlind Kabashi ka dorëzuar CV-në dhe referencat, mirëpo as CV dhe referencat nuk dëshmojnë se Z. Kabashi ka realizuar mbikëqyrje sipas kërkesës së DT. Kthehemi tek rregullorja 01/2022 të Prokurimit Publik dhe

udhëzuesi 01/2023 Prokurimit Publik, në rastin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE i rekomanduar, për Z. Mirlind Kabashi CV- e dorëzuar nuk përmbush kërkesat – refuzo tenderin. Se nuk ka realizuar asnjë mbikëqyrje të projekteve të ngjashme, na jep me kuptu edhe referenca e lëshuar nga një OE Fidani-L për Z. Kabashi. Nëse shohim CV nuk ta të përshkruar asnjë projekt për mbikëqyrje të projekteve të ngjashme, në paragrafin e tret të referencës se lëshuar me datë 20.01.2023 thuhet: Zt. Kabashi prej themelimit te marrëdhënies se punës ne kompaninë si menaxher i disa projekteve dhe udhëheqës i punimeve (mbikëqyrje) për projekte te kontraktuara nga kompania jonë: Pra udhëheqës i punimeve nuk i bijën ekuivalente me mbikëqyrje, janë të dy anë të ndryshme, e dëshmon edhe lista e kontratave që asnjëra nga titujt në referencë nuk janë mbikëqyrje, që rrjedhimisht dhe përfundimisht i bie që Z. Mirlind Kabashi nuk ka asnjë kontratë të kompletuar në lidhje me kërkesën në DT të këtij Aktiviteti të prokurimit. Dhe ku vie absurdi i përgjigjes në vendimin rishqyrtimit nga AK, datës 02.08.2023, në lidhje me këtë pretendim, ne kemi dhënë si shembull se si duket një titulli projektit në raste të mbikëqyrjes së projekteve, ndërsa AK jep përgjigje se ne nuk kemi kërkuar kontratë për mbikëqyrje, kontratë e dimë që nuk ka kërkuar, mirëpo ka kërkuar që stafi të ketë Minimum një referencë si mbikëqyrës i projekteve të ngjashme, sipas kërkesës së DT 9.1 kërkesa 2. Nuk kemi pretenduar se AK ka kërkuar në dosje të tenderit kontratë për mbikëqyrje të projekteve, e dim dhe ne si OE kemi përmbush këtë kërkese sipas DT kërkesa 2, e OE i rekomanduar për kontratë, respektivisht Z. Kabashi nuk ka asnjë projekt në cilësinë e mbikëqyrësit, rrjedhimisht i bie qe OE i rekomanduar nuk përmbush këtë kërkesë.

- *Pretendimi i gjashte (VI)*- OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesën e DT në lidhje me planin dinamik. Pasi e kemi pranuar ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, e kemi analizuar dhe fituesi ka ofruar plan dimanik për vetëm 40 pozicione, nga gjithsej 200 pozicione në paramasë, i bie që ka dhënë plan dinamik për 20% të pozicioneve të paramases, pra fituesi nuk e plotëson këtë kërkese sepse në dosje është kërkuar plan dinamik, …duke u përfshirë te gjitha aktivitetet (pozicionet) qe janë te përfshira ne paramase. OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dhënë plan dinamik sipas kërkesës për pozicionet e paramasës. Dhe në përgjigjen e pretendimit nr 5 nga AK, në kërkesën për rishqyrtim jep në këtë formë: Në kuptimin logjik i bie qe " qysh e ka bo bërllog OE i rekomanduar e keni bërë edhe ju", edhe pse kemi dhënë deklaratë në lidhje planin dinamik dhe në të njëjtën kohe kemi dhënë plan dinamik për të gjitha pozicionet sipas kërkesës së DT.

- *Pretendimi i shtatë (VII)*- OE i rekomanduar për kontratë, në ofertën e tij e ka dorëzuar pajisjen për shpime horizontale dhe për të njëjtën ka dorëzuar si dëshmi një kontrate për qira e cila nuk është valide, sepse: Kontrata është e lidhur me mes te Ricommerce construction dhe Infra Plusit, marrëveshje e cila është NUL, sepse kjo pajisje është marrë me lizing në shtetin e Bullgarisë dhe në veçanti kjo pajisje sipas marrëveshjes nuk guxon të nxirret jashtë shtetit Bullgar, shih: Follderin nr. 17, makina për shpime horizontale, te drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit, faqe nr 36, ku kufizohen te drejtat e qiramarrësit, lidhur me përdorimin e makinerisë në fjalë: Sipas të drejtave të përcaktuara në këtë nen, operatori ekonomik nuk ka të drejte ta nxjerr jashtë territorit te Republikës së Bullgarisë, rrjedhimisht OE i rekomanduar për kontrate, vetëm sa për të mbuluar kërkesën e dosjes së tenderit i ka dorëzuar këto dëshmi, e që nuk mund ta përdorë

asnjëherë sepse ne piken 6 te nenit 21 sanksionohet nxjerrja jashtë territorit të kësaj pajisje.

- *Pretendimi i tetë (VIII)*- Pretendim tjetër është i rekomanduari për kontrate, ka dorëzuar certifikata të salduesve në gjuhë jo zyrtare, pra jashtë gjuhëve ku një OE duhet të paraqes një ofertë, dhe që janë në kundërshtim me nenin 13 te LPP-së. Detalisht nga dokumenti i dorëzuar nga OE, jashtë nenit 13 të LPP-së. Pra, dëshmia është në kundërshtim me nenin 13 të LPP-së. Pra, nuk kuptohet se për çfarë lloji te saldimit janë testuar. Kërkojmë që shqyrtimi të jetë i barabartë për palët, sipas nenit 7 të LPP-së, pa ndonjë anim miqësor apo interesi tjetër dhe aktiviteti i prokurimit të rivlerësohet në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim dhe ankesa jonë të aprovohet si e bazuar.

Konstatimet e ekspertit për ankesën 582/23

- *Konstatimi i parë (I)*- Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te bëjë me publikimin e procesverbalit të hapjes së ofertave eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja në përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim të OE ankues ka bashkangjitur komunikimin përmes emailave me help deskun brenda KRPP në bazë te të cilit ka dëshmuar se ka probleme me hapjen e ofertave. Në këtë rast AK-ja ka vepruar ne përputhje me nenin Neni 35 Hapja e Tenderëve elektronik paragrafi 35.12 Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi për këtë pikë i OE ankues nuk është i bazuar.

- *Konstatimi i dytë (II)*- Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim nuk ka qenë pjesë e pretendimeve në kërkesën për rishqyrtim te dorëzuar pranë AK-se e cila rezulton se nuk është ne përputhje me nenin 13 te RRP se OSHP pika 9. Lidhur me këtë pretendim RRPP 001/2022 neni 40.3 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesverbali i hapjes se tenderit ka qene me datën 05.06.2023 ndërsa vlerësimi ka përfunduar me datën 24.07.2023. Vlerësimi i AK-se ka qene brenda afatit te definuar me rregullore por qe AK-ja nuk ka bashkangjitur në sistemin e e-prokurimit ndonjë arsyetim mbi zgjatjen e afatit të vlerësimit. Prandaj bazuar në sqarimet si më lartë pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

- *Konstatimi i tretë (III)*-Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka të bëjë me kërkesat sipas nenit 9.1 & 9.2 eksperti shqyrtues sqaron se sipas dosjes se tenderit kërkesa është: **Kërkesa 9:** Kontrata të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, të përfunduara me Sukses gjatë 3 (tre) vitet e fundit, deri në datën e publikimit të këtij Njoftimi të Kontratës; Vlera Totale e Kontratave të natyrës së punëve të ngjashme si të tilla mund të konsiderohen të gjitha referencat për punimet e infrastrukturës si Ujësjellës, Kanalizime, dhe Rrugë te jete min 4,000,000.00 Euro. Shënim: Në rast të konzorciumit, udhëheqësi i grupit duhet të mbulojë së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë. Dëshmia 9: Lista e Kontratave të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, Listës së kontratave duhet ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet e pranimeve teknike për kontratat e prezantuara në listë. OE ankues në listën e kontratave të dorëzuara me ofertë ka dorëzuar 11 kontrata. AK-ja gjatë vlerësimit ka pranuar 10 prej tyre

derisa nuk e ka pranuar kontratën me nr. rendor 1 e cila është e evidentuar si e kompletuar me datën 25.02.2020. Ne bazë të njoftimit mbi eliminimin e OE ankues, lista e kontratave të dorëzuara nuk e plotëson kriterin e kërkuar qe *"lideri te mbuloje 60% te referencave".* Sipas UOPP neni 8 pika iii) Në të gjitha rastet e përfshira në 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 të LPP- se përmendet shprehja si në vijim citojmë: " *të realizuara (përfunduara) në tri vitet e shkuara "ose " në periudhën e shkuar trevjeçare..."*). Ne kuptimin e Ligjit shprehja "tri vitet e shkuara" nënkupton: " periudhën kohore të përcaktuar ne këto nene e cila ndërlidhet me periudhën qe paraprinë datën e publikimit të njoftimit për kontrate. Ne kuptim të nenit 69 paragrafi 2.1, 4.2 dhe 6.2 shprehja "te realizuara ne tre vitet e shkuar"nënkupton Kontratat për furnizime, shërbime dhe/ose pune të realizuara (përfunduar) ne periudhën e shkuar tre vjeçare (periudha e sqaruar si me lartë). Sipas dosjes se tenderit publikimi i njoftimit për kontrate është bere me datën 24.03.2023. Definimi sipas UOPP *"Ne kuptimin e Ligjit shprehja "tri vitet e shkuara" nënkupton: " periudhën kohore të përcaktuar ne këto nene e cila ndërlidhet me periudhën qe paraprinë datën e publikimit të njoftimit për kontrate"*, Kjo nënkupton se AK gjatë vlerësimit te listës se kontratave te dorëzuara me ofertën e OE ka vepruar ne përputhje me UOPP dhe LPP-ne. Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues në këtë pike nuk është i bazuar.

- *Konstatimi i katër (IV)*-Lidhur me pretendimin ankimor të OE qe ka te bëjë me kërkesën 5 - 1 (një) makinë për shpuarjen nëntokësore horizontale me sistem laserik ose makinë shpuese pa llaser të kontrollit deri në diametrin 500 mm. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit me validitet ndërsa pajisjet tjera, OE duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e tyre (faturë, DUD etj.). Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet te ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Eksperti shqyrtues sqaron se me ofertë OE ankues ka dorëzuar DUD doganor me përshkrim të pajisjes Ditch Witch JT 2720. Në DUD nuk ka përshkrim se pajisja e njëjtë është në përputhje me kërkesën e dosjes se tenderit. OE ankues në kërkesën për rishqyrtim dhe në ankesë në pretendimin e tij i referohet se "me kërkesë të thjeshtë ne internet mund të verifikohet lehtë" por nuk ka bashkëngjit asnjë dëshmi qe të vërtetojë pretendimet e tij apo uebfaqe në të cilën e ka verifikuar të njëjtën. Prandaj ne këtë rast eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues nuk ka plotësuar kërkesat sipas nenit 26.8 pika 3 c) kriteret minimale te kualifikimit. AK-ja ne këtë pikë ka vepruar në përputhje me nenin 59 paragrafi 4 lidhur me nenin 40.6 pika b), c). Prandaj bazuar në sqarimet e dhëna më lartë eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor nuk është i bazuar.

- *Konstatimi i pestë (V)*-Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka të bëjë me inxhinierin M.K të OE te rekomanduar për kontratë në lidhje me kërkesën 2. Kërkesa 2: Dy (2) udhëheqës të punimeve, Inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik ose Master i shkencave hidroteknike , me përvoje minimale prej 5 vite pas diplomimit dhe në udhëheqje të punimeve të ngjashme. Evidenca 2:Minimum një referencë si mbikëqyrës i projekteve te ngjashme. Pretendimi i OE ankues në këtë pikë është se inxhinieri nuk e plotëson kërkesën për "minimum një referencë si mbikëqyrës i projekteve të ngjashme". Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja në bazë të dosjes së tenderit ka kërkuar që kërkesa 2 të dëshmohet me "referenca". OE i

rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dy referenca ne emër te inxhinierit nga OE "Fidani AL" dhe AK Komuna e Gjakovës. Referencat e bashkangjitura janë në përputhje me kërkesën e AK-se për mbikëqyrje të projekteve. AK-ja në përgjigjen ndaj pretendimit te OE ankues ku i referohet si shembull: kontratës se mbikëqyrjes me Ministrinë e Tregtisë më të drejtë e ka vlerësuar se kërkesa e dosjes se tenderit është qe Mbikëqyrja te dëshmohet me referencë për inxhinierin dhe jo për subjektin juridik (OE). Prandaj Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja gjatë vlerësimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë në këtë pikë ka vepruar në përputhje me nenin 59 te LPP-se. Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "" K-ING " SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit në komunën e Fushë Kosovës në lagjen 28, 29, Bardh i Madh dhe Sllatinë e Madhe""me numër të prokurimit: "212-23-2115-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal MAPL. Prandaj duke u bazuar në sqarimet e mësipërme eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi nuk është i bazuar.

- *Konstatimi i gjashtë (VI)*-Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka të bëjë me planin dinamik te OE të rekomanduar për kontratë eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa e dosjes se tenderit është: Kërkesa 6. OE duhet të dorëzon me Ofertën e tij, "Planin Dinamik të Detajuar"; Dëshmia 6. Plani Dinamik - duhet të prezantohet sa më i detajuar i mundshëm (duke i përfshirë të gjitha aktivitetet (pozicionet) që janë të përfshira në paramasa. OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar vetëm 40 pozicione nga 200 pozicionet te paramasës. Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar planin dinamik për 151 pozicione. Ne pozicione janë te përfshira te gjitha aktivitetet qe janë pjesë e paramasës dhe para llogarisë pjesë të dosjes se tenderit. Pjesa qe nuk janë përfshirë kane të bëjnë me nën pozicione për furnizime të cilat janë pjesë e aktiviteteve të përfshira në planin dinamik. Vlen të theksohet se afati i përfundimit të planit dinamik nuk ka ndryshuar që dtth se aspektet materiale të dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate nuk janë prekur. Për me tepër dosja e tenderit neni 12.1 i KVK e përcakton se plani dinamik është dokument qe duhet te azhurnohet pra është kusht kontraktual. Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi për këtë pikë mund te kualifikohet si "devijim i vogël" në përputhje me Nenin 59.4 pika ii) te LPP-se lidhur me nenin 45.19 dhe 45.20 te RRPP. Prandaj duke u bazuar ne sqarimet e dhëna eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi është pjesërisht i bazuar.

- *Konstatimi i shtatë (VII)*-Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me makinën e shpimit dhe kushtet e kontratës se shfrytëzimit të makinës dhe konstatimin se "pajisja nuk guxon te nxirret jashtë shtetit Bullgar "eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë me ofertën e tij ka dorëzuar marrëveshjen për shfrytëzim me qira me OE "Rai Commerce". Pra sipas marrëveshjes pajisja mund te shfrytëzohet edhe jashtë vendi nëse merret pëlqimi paraprak. Është obligim i OE të rekomanduar për kontratë qe të marr pëlqimet e nevojshme pas nënshkrimit te kontratës. Eksperti shqyrtues në këtë pikë vlerëson se kërkesa e dosjes se tenderit është përmbushur derisa pretendimi i OE ankues është subjekt i mos përmbushjes se kushteve kontraktuale ne mes te dy palëve kontraktuese. Prandaj bazuar ne dokumentet e administruara për këtë pretendim eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor nuk është i bazuar.

· *Konstatimi i tetë (VIII)*- Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim nuk ka qenë pjesë e pretendimeve në kërkesën për rishqyrtim te dorëzuar pranë AK-se e cila rezulton se nuk është ne përputhje me nenin 13 te RRP se OSHP pika 9. Lidhur me këtë pretendim eksperti shqyrtues sqaron se ne baze te dosjes se tenderit pika Kërkesa 4. Tre (3) Saldues për gyp HDPE, të certifikuar sipas EN-13067. Evidenca 4: Kopja e noterizuar e certifikatës së trajnimit e lëshuar nga një institucioni i autorizuar për trajnime të tilla. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar certifikatat EN13067 Eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa e dosjes se tenderit është qe të dëshmohet standardi i certifikimit EN-13067 dhe jo "procesi i saldimit" prandaj vlerëson se dokumentet e dorëzuara me ofertë janë ne përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit. Prandaj duke u bazuar ne sqarimet e dhëna me lartë eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi është i pabazuar.

Konstatimet dhe gjetjet e panelit shqyrtues

Argumentimet në raportin e super ekspertizës së cituar si më sipër të ekspertit shqyrtues janë të detajuara, të kuptueshme dhe të bazuar në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP dhe rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me analizimin e pretendimeve të ankuesve i ka falur besimin raportit super ekspertizës së ekspertit shqyrtues. Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatoreve Ekonomik duhet të refuzohen si te pabazuara. Vlenë të theksohet se këto të gjetura janë evidentuar edhe në raportin paraprak të ekspertizës për të cilën paneli nuk e mori parasysh. Paneli në ketë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura në raportin e superekspertizës, si dhe duke u bazuar tek nenet 32 të RRPP "Është përgjegjësi e ofertuesit të ngarkoj të gjitha dokumentet e kërkuara në sistemin e prokurimit elektronik para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve" duke u bazuar në nenin 69 të LPP, si dhe interpretimin e KRPP nr. 10 të publikuar në ueb faqen e saj.

Andaj PSH vlerëson se ankesat e OE Alfa.I" dhe "K-Ing" SH.P.K janë pjesërisht të bazuara, por të cilat nuk kanë arritur per te ndryshuar rezultatin përfundimtar të aktivitetit të prokurimit.

Per faktin se sa i perket ankeses se Alfa I - konform dispozitave të lartcekura si dhe vetë kërkesës për sqarim nga ana e AK në të cilën potencohet se nëse i njejti nuk dorëzon dokumentacionin oferta e tij refuzohet, citat neneve të RRPP "38.6 AK do të caktoj afat kohor të arsyeshëm për OE për sqarim të tenderit të tyre. 38.7 Nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK sipas paragrafit 38.6 tenderi përkatës do të refuzohet".

Ndërsa sa i përket ankeses së King shpk, pavarësisht se i njejti ka mundur të ketë paqartësi në kërkesën e DT ku potencohet 3 vite deri në datën e njoftimit për kontratë, LPP përcakton qartë e poashtu rregulloret në fuqi që 3 vite nga data e njoftimit për kontratë, duke u bazuar në nenin 69 të LPP, si dhe interpretimin e KRPP nr. 10 të publikuar në ueb faqen e saj, citat "*Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron interpretimin ligjor si në vijim: Sa i përket dëshmive të kërkuara nga Autoritetet kontraktuese në FTD të Dosjes së tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në lidhje me Aftësitë teknike dhe/ose profesionale, paragrafi 4.2 i nenit 69 të këtij ligji përcakton: 4.2 listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira,shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja ecertifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkënënshkrura nga autoriteti i tillë publik: (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë; Në kuptim të nën-paragrafit 4.2 të nenit 69 të lart cituar, AK në rast se kërkon dëshminë - Listën e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit, (nga data e njoftimit për kontratë) kjo do të thotë që kontratat e kërkuara nga AK, duhet të jenë të realizuara (jo në realizim e sipër) pra të përfunduara brenda tri viteve të shkuara nga data e njoftimit për kontratë. Pra për bazë duhet të merret periudha e përfundimit jo e fillimit të kontratës. Për më shumë, kjo do të thotë se në këtë listë duhet të saktësohen të gjitha informatat e hijezuara në këtë nën-paragraf: Llojin e shërbimeve, shumën e kontratës që nënkupton totalin e përgjithshëm të kontratës, datën dhe pranuesin*"

Paneli shqyrtues sqaron se sa i përket kritereve të cilat mund të mos jenë të kuptueshme apo me dy kuptimësi atëherë OE këtë duhet ta paraqesin në fazën para dorëzimit të ofertës duke kërkuar sqarime shtesë, dhe po ashtu ka të drejtë ti drejtohet edhe organit shqyrtues të prokurimit duke i atakuar këto kërkesa, gjë e cila nuknë rastin konkret nuk ka ndodhur nga OE ankues. Andaj, PSH në rastin konkret i referohet vetëm dispozitave ligjore mbi të cilat AK mund të paraqes kërkesën. Kështu që OE ankues sipas ekspertit shqyrtues dhe PSH, nuk ka arritur të plotësoj kërkesën e dosjes së tenderit sa i përket kontratave të realizuara brenda periudhës prej 3 viteve nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

- Përfundim -

Paneli shqyrtues konsideron se pohimet ankimore nuk janë të bazuar, sikurse është shpjeguar dhe si më sipër, kurse AK ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 7, 59 dhe 60 të LPP. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit në ri-vlerësim, pa fakte dhe prova jo kontestuese dhe/ose pa bazë ligjore, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicoj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit. Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Po ashtu, Paneli Shqyrtues niset gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit dhe konform nenit 24, paragrafi 2 i LPP janë përgjegjës së aktiviteti i prokurimit të zhvillohet konform dispozitave ligjore në fuqi.

Prandaj duke ju referuar të lartcekurave dhe duke u bazuar në administrimin e gjithmbarshëm të provave, në dispozicion të shkresave të kësaj lënde, Paneli Shqyrtues bazuar në nenin 98,99 lidhur me nenin 104 dhe 118 të LPP, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi si në pikën 3 të dispozitivit u mor për shkak se OE shumicën e pretendimeve të tyre i kishin të bazuara apo pjesërisht të bazuara. Megjithatë nuk kanë arritur të ndryshojnë rezultatin përfundimtar dhe të ndryshojnë vendimin e AK.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal MAPL, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal MAPL**
- OE - **ALFA.i, " K-ING " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: